

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje eskavator me goma.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Makineri eskavator - 43262000-7.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 000 000 (gjashtë milion)lekë pa TVSH dhe 7 200 000 (shtatë milion e dyqind mijë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formularin e ofertës dhe listën e cmimeve të artikujve sipas shtojcave 1 dhe 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët*

ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit. Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojcës nr.9).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë garancie per mjetin per nje periudhe jo me pak se 6 muaj dhe ne rast te defekteve, gjate kohes se riparimit te zevenedsoje mjetin me nje mjet alternativ te perafert me te.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi një vit garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.4.Operatori ekonomik pjesemarres duhet te paraqese “Licence per Blerje dhe Shitje e mjeteve dhe pjeseve te nderrimit te tyre, Kodi VII.3.B”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe tëligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Përlicencat, autorizimetdhejetnëRepublikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike te hartuara mbi bazen e nevojave te Bashkise Malesi e Madhe per tu pajisur me nje mjet te tipit “Eskavator me goma”, me te cilen synohet kryerja sherbimeve ne sektorin e Bordit te Kullimit, jane si me poshte vijon:

Tipi: Makine teknologjike e llojit Eskavator me goma

Viti i prodhimit: minimumi 2005.

Motorr turbo te pakten 80 kw’.

Lënda djegëse ;Naftë.

Vellimi ne cm3 te jete te pakten 2500.

Rrota aktive 4x4.

Numri i cilindrave: 4

Ore pune: jo me shume se 5000.

Kutia e shpejtësisë të jetë automatike.

Te jete i pajisur me kova germimi me dimenion 80cm.

Te jete i pajisur me kova pastrami me dimenion 180 cm.

Shkarkimet e gazrave djegës nga motori duhet të jenë në perputhje me legjislacionin në fuqi.

Të disponoje kolone me thyerje majtas dhe djathtas .

Të jetë i pajisur me impjant per pastrimin e kanaleve, impiant hidraulik çekiçi dhe çekiç te ri.

Forca e çekiçit te jete te pakten 800kg/ore

Të jetë i pajisur me thike para

Kembe fiksuese mbrapa.

Kabinë me kondicioner.

Gomat e mjetit të jene te reja.

Pesha e mjetit te pakten 17 ton.

Të përgjigjet për periudhën 6-mujore për difektet të medha jashtë përgjegjësisë së shoferit.

Të mos ketë shënja ndryshku apo shenja të kësaj natyre.

Specifikimet teknike te mjetit te kerkuar jane hartuar duke u bazuar ne fondin maksimal qe ka ne dispozicion Bashkia, nevojën e autoritetit kontraktor dhe terrenin ku do te operoje mjeti.

Viti i prodhimit eshte kerkuar minimumi 2005 duke patur parasysh qe i korrespondon edhe vleres se fondit si edhe nje game produktesh qe i pershtaten nevojave te AK.

Kufiri maksimal i oreve te punes (5000) eshte kerkuar duke patur parasysh edhe vitin e prodhimit si edhe gjendjen e kerkuar te mjetit.

Forca e mjetit dhe specifikimet tjera lidhur me motorrit jane kerkuar te tilla duke patur parasysh llojin e mjetit si dhe terrenin ku do te operoje.

Ndersa pajisjet teknike te kerkuara si kovat dhe impjantet tjera jane kerkuar bazuar ne qelimin e sherbimit te mjetit objekt prokurimi.